



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E FINANCËVE - MINISTARSTVO ZA FINANSIJE - MINISTRY OF FINANCE	
Njësia për Inteligjencë Financiare - Finansijska Obaveštajna Jedinica Financial Intelligence Unit		
Nr./Br.	FIUAD: 4/2015	Nr.faq./br.stz.
Data/Datum	12/01/2015	
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA		

**URDHËRESË ADMINISTRATIVE NJIF-K Nr. 02/2015
PËR PARANDALIMIN DHE ZBULIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE**

**ADMINISTRATIVNA DIREKTIVA FOJ-K Br. 02/2015
O SPREČAVANJU I OTKRIVANJU PRANJA NOVCA**

**ADMINISTRATIVE DIRECTIVE FIU-K No. 02/2015
ON PREVENTION AND DETECTION OF MONEY LAUNDERING**

Në pajtim me nenin 14 të Ligjit Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 85, 9 nëntor 2010), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-178 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 5, 8 mars 2013), dhe me qëllim të sigurimit dhe promovimit të pajtueshmërisë me ligjin në fuqi, Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës lëshon këtë:

**URDHËRESË ADMINISTRATIVE NJIF-K
Nr. 02/2015
PËR PARANDALIMIN DHE ZBULIMIN E
PASTRIMIT TË PARAVE**

**Neni 1
Shkurtesat**

1. **NJIF-K**- Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës
2. **LPP/PFT** - Ligji Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-178
3. **RTG** - Raport i Transaksionit në Para të Gatshme
4. **RAD** - Raport mbi Aktivitetet e Dyshimta

Na osnovo Člana 14. Zakona Br. 03/L-196 o sprečavanju pranja novca i finansiranja terorizma (Službeni List Republike Kosova Br. 85, 9 od novembra 2010), izmenjen i dopunjen Zakonom Br. 04/L-178 o Izmeni i Dopuni Zakona Br. 03/L-196 o Sprečavanju Pranja Novca i Sprečavanju Finansiranja Terorizma (Službeni List Republike Kosovo Br. 5, od 8 marta 2013), i u cilju osiguravanja usaglašenost sa zakonom, Finansijska Obaveštajna Jedinica Kosova donosi:

**ADMINISTRATIVNA DIREKTIVA
FOJ-K Br. 02/2015
O SPREČAVANJU I OTKRIVANJU
PRANJA NOVCA**

**Član 1
Skraćenice**

1. **FOJ-K** - Finansijska Obaveštajna Jedinica Kosova
2. **ZSP/NFT**- Zakon Br. 03/L-196 o sprečavanju pranja novca i finansiranja terorizma, izmenjen i dopunjen Zakonom Br. 04/L-178
3. **IGT** - Izveštajo Gotovinskoj (Keš) Transakciji
4. **ISA** - Izveštaj o Sumnjivim Aktivnostima

Pursuant to Article 14 of the Law No. 03/L-196 on the prevention of money laundering and terrorist financing (Official Gazette of Republic of Kosovo No. 85, 9 November 2010), as amended by Law No. 04/L-178 on Amending and Supplementing the Law No. 03/L-196 on the Prevention of Money Laundering and Prevention of Terrorist Financing (Official Gazette of Republic of Kosovo No. 5, 8 March 2013), and in order to ensure compliance with the law, the Director of the Financial Intelligence Unit of Kosovo issues:

**ADMINISTRATIVE DIRECTIVE
FIU-K No. 02/2015
ON PREVENTION AND DETECTION OF
MONEY LAUNDERING**

**Article 1
Abbreviations**

1. **FIU-K** - Financial Intelligence Unit of Kosovo
2. **LPM/LTF** - Law No. 03/L-196 on the prevention of money laundering and terrorist financing, as amended and supplemented by law No. 04/L-178
3. **CTR** - Cash Transaction Report
4. **SAR** - Suspicious Activity Report

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi dhe objektivat e aplikimit</p> <p>1. Kjo Urdhëresë Administrative është e aplikueshëm për subjektet raportuese siç përcaktohen në nenin 16 të LPP/PFT dhe institucionet publike siç definojnë në dispozitat e LPP/PFT dhe dispozitat e kësaj urdhërese.</p> <p>2. Objektivat kryesore të kësaj urdhërese administrative janë që të:</p> <p>2.1. Parandaloj dhe luftoj pastrimin e parave duke vendosur rregulla, procedura dhe indikatorë për subjektet raportuese;</p> <p>2.2. Parandaloj përdorimin e shërbimeve, lehtësirave apo resurseve të bankave dhe institucioneve tjera financiare në Kosovë nga personat dhe entitetet e dyshuara për pastrim të parave;</p> <p>2.3. Ofroj përkrahje subjekteve raportuese duke përpiluar listën e indikatorëve për pastrimin e parave me qëllim të aplikimit të kujdesit të duhur, gjatë punës së biznesit të tyre.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Obim i ciljevi primene</p> <p>1. Ovo Administrativna Direktiva se primenjuje na izveštajne subjekte navedene u članu 16 ZSPNFTi javne institucije kao što je definisano odredbama ZSPNFT i odredbama ovog direktiva.</p> <p>2. Glavni ciljevi ovog administrativna direktiva su da:</p> <p>2.1. Spreče i suzbije pranje novca postavljanjem pravila, procedure i indikatora za izveštajne subjekte;</p> <p>2.2. Sprečecorišćenja usluga, objekata ili izvora banaka i drugih finansijskih institucija na Kosovu za pranje novca od strane osumnjičenih lica i subjekata;</p> <p>2.3. Pruži podršku izveštajnim subjektima uspostavljanjem liste indikatora pranje novca s ciljem obavljanja dužne pažnje, prilikom obavljanja svojeg poslovanja.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope and objectives of application</p> <p>1. This Administrative Instruction is applicable to reporting subjects stated in the Article 16 of the LPMLTF and public institutions as defined by provisions of LPMLTF and provisions of this directive.</p> <p>2. The main objectives of this administrative directive are to:</p> <p>2.1. Prevent and combat money laundering by setting out rules, procedures and indicators for reporting subjects;</p> <p>2.2. Prevent the use of the services, facilities or resources of banks and other financial institutions in Kosovo by suspected persons and entities for money laundering;</p> <p>2.3. Provide support to reporting subjects by establishing the list of indicators of money laundering with the purpose of conducting due diligence, when conducting their business.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Obligimet e subjekteve raportuese</p> <p>1. Subjektet raportuese janë të obliguara të vlerësojnë transaksionet e klientëve të tyre duke u bazuar në indikatorët e vendosur në aneksin 1 të kësaj Urdhërese Administrative.</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Obaveze izveštajnih subjekata</p> <p>1. Izveštajni Subjekti su dužni da procene transakcije svojih klijenata na osnovu pokazatelja koji su postavljeni prema aneksu 1 ovog Administrativna Direktiva.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Obligations of reporting entities</p> <p>1. Reporting subjects are obliged to evaluate their client's transactions based on the indicators set under annex 1 of this Administrative Directive.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 4 Procedurat e brendshme mbi parandalimin e pastrimit të parave</p> <p>1. Ndryshimet në procedurat e brendshme me shkrim të bankave dhe institucioneve financiare të parashikuara në nenin 23, paragrafi 2 i LPP/PFT duhet të përfshijnë obligimet që dalin nga kjo urdhëresë dhe do të dërgohen NJIF-K dhe BQK.</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Interne procedure o sprečavanju pranja novca</p> <p>1. Promene u pisanim internim procedurama banaka i finansijskih institucija propisanim u Članu 23, stav 2 ZSPNFT treba da sadrži obaveze koje proizilaze iz ove direktive iće se dostaviti FOJ-K i CBK.</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Internal procedures on prevention of money laundering</p> <p>1. Changes to written internal procedures of banks and financial institutions prescribed in Article 23, paragraph 2 of the LPMLTF shall include the obligations deriving from this directive and shall be submitted to the FIU-K and CBK.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Aplikimi i kujdesit të duhur të klientit mbi pronarët përfitues të më shumë se 20% të personit juridik</p> <p>1. Me qëllim të ushtrimit të obligimit për identifikimin e pronarit përfitues dhe/ose personit fizik apo personave që në mënyrë të drejtpërdrejt apo tërthorazi kontrollojnë 20% a më shumë të personit juridik, siç kërkohet nga neni 17, paragrafi 1.2 i LPP/PFT, subjektet raportuese, si minimum, do të përdorin burimet e informacionit si në vijim:</p> <p>1.1 Agjencia për Regjistrimin të Bizneseve të Kosovës;</p> <p>1.2 Informatat e mëparshme të mbledhura duke u bazuar në LPP/PFT; dhe</p> <p>1.3 Të kërkojnë informatat në vijim nga klientët e tyre:</p> <p>1.3.1 Dokumentet për themelimin e biznesit (ose kontratat ose marrëveshjet);</p>	<p style="text-align: center;">Član5 Primena dužne pažnje kljentima na korisničke vlasnike od preko 20% pravnog lica</p> <p>1. Da bi se izvršila obaveza identifikovanja korisničkog vlasnika i/ili fizičkog lica ili lica koja direktno ili indirektno kontrolišu 20% ili više od jednog pravnog lica kao što je propisano članom 17. stav 1.2 ZSPNFT, izveštajni subjekt iće kao minimum koristiti sledeće izvore informacija.</p> <p>1.1 Kosovsku Agenciju za Registraciju Biznisa;</p> <p>1.2 Prethodne informacije koje su prikupljene na osnovu ZSPNFT; i</p> <p>1.3 Zahtevati sledeće informacije od svojih klijenata:</p> <p>1.3.1 Dokumente za osnivanje biznisa (ili ugovore ili sporazume);</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Application of customer due diligence on beneficial owners of more than 20% of legal person</p> <p>1. In order to perform the obligation of identifying the beneficial owner and/or a natural person or persons who directly or indirectly control 20 % or more of a legal person as required by Article 17, paragraph 1.2 of the LPMLTF, reporting subjects shall as a minimum use the following sources of information:</p> <p>1.1 Kosovo Business Registration Agency;</p> <p>1.2 Previous information collected based on the LPMLTF; and</p> <p>1.3 Require the following information from their customers:</p> <p>1.3.1 Business establishment documents (or contracts or agreements);</p>

<p>1.3.2 Statutin e entitetit ligjor;</p> <p>1.3.3 Kontratat apo dokumentet tjera në lidhje me pronësinë e personit juridik;</p> <p>1.3.4 ID, pasaportën dhe dokumentet tjera identifikuese valide për identifikimin e pronarëve;</p> <p>1.3.5 Vendimin apo kontratat mbi emërimin e drejtorit(ve);</p> <p>1.3.6 Çdo informatë tjetër e cila mund të ishte e dobishme për identifikimin e pronarit përfitues të personit juridik.</p>	<p>1.3.2 Statut pravnog lica;</p> <p>1.3.3 Ugovori ili drugi dokumenti koji se odnose na vlasništvo pravnog lica;</p> <p>1.3.4 Lične karte, pasoše i druge identifikacioni dokumenti za identifikaciju vlasnika;</p> <p>1.3.5 Odluku ili ugovore o imenovanju direktora/direktore;</p> <p>1.3.6 Bilo koje druge informacije koje mogu biti potrebne (korisne) za identifikaciju korisničkog vlasnika pravnog lica.</p>	<p>1.3.2 Statute of legal person;</p> <p>1.3.3 Contracts or other documents related to the ownership of legal person;</p> <p>1.3.4 ID, passport and other identification documents to identify the owners;</p> <p>1.3.5 Decision or contracts on appointing director(s);</p> <p>1.3.6 Any other information that may be necessary to identify the beneficial owner of legal entity.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6 Indikatorët e pastrimit të parave</p> <p>1. Aneksi i kësaj Direktive Administrative liston indikatorët të cilët mund t'iu ndihmojnë subjektet raportuese në identifikimin e dyshimit të pastrimit të parave, veprat e ndërlidhura penal apo financimin e terrorizmit. Lista duhet të trajtohet si listë jo shteruese/përfundimtare.</p> <p>2. NJIF-K do të mirëmbajë dhe sipas nevojës do të përditësoj listën e indikatorëve për pastrimin e parave.</p> <p>3. Subjektet raportuese do të mbajnë shënim për indikatorëve gjatë të vepruarit në pajtueshmërisë me LPP/PFT dhe veçanërisht gjatë aplikimit të kujdesit të duhur ndaj klientit, shpalljes së</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Pokazatelji pranja novca</p> <p>1. Aneks (Prilog) 1 ovog Administrativna Direktiva nabraja pokazatelje koji mogu da pomognu izveštajnim subjektima u identifikovanju osumnjičenog pranja novca, njenog predikatnog krivičnog dela ili finansiranja terorizma. Spisak treba biti tretiran kao neiscrpnii spisak pokazatelja.</p> <p>2. FOJ-K će održavati i, po potrebi, ažurirati spisak o indikatorima (pokazateljima) za pranje novca.</p> <p>3. Izveštajni subjektii će obratiti pažnju na pokazatelje kada postupaju u saglasnosti sa ZSPNFT i posebno prilikom primene duzne paznje klijenta, donošenjem pismenih</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Indicators of money laundering</p> <p>1. Annex 1 of this Administrative Directive lists indicators which may assist reporting subjects in identifying suspected money laundering, its predicate offences or terrorism financing. The list should be treated as a non-exhaustive list of indicators.</p> <p>2. The FIU-K shall maintain and, when needed, update the list on indicators for money laundering.</p> <p>3. Reporting entities shall take note of the indicators when complying with the LPMLTF and specifically when applying customer due diligence, promulgating written internal</p>

procedurave të brendshme me shkrim, raportimit tek NJIF-K të akteve të dyshimta apo transaksioneve dhe gjatë trajnimit të punëtorëve të tyre.

Neni 7 Formularët raportues

1. Të gjitha subjektet raportuese duhet të dërgojnë RAD dhe RTG në pajtim me ligjin në fuqi dhe specifikat e përcaktuara nga NJIF-K.
2. NJIF-K do të vazhdoj të informon subjektet raportuese përkthazi me çdo ndryshim lidhur me format standarde të raportimit.
3. Formular specifik raportues mund të jenë të aplikueshëm për subjekte të ndryshme raportuese. NJIF-K do të vë në dispozicion formularë në ueb-faqen e NJIF-K dhe do të ofroj udhëzime mbi aplikimin e këtyre formularëve.

Neni 8 Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë Administrative hyn në fuqi 15 ditë pas nënshkrimit nga Drejtori i Njesisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës.

Prishtinë, 12/01/2015


Dardan NUHIU
Drejtor, Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës

internih procedura, izveštavajuci FOJ o sumnjivim aktima ili transakcijama i u obučavanju svojih zaposlenih.

Član 7 Obrasci (Formulari) za izveštavanje

1. Svi izveštajni subjekti moraju da podnesu IST i IGT u skladu sa zakonom na snazi i specifikacijama definisanim od strane FOJ-K.
2. FOJ-K će nastaviti obavestiti izveštajne subjekti sa svakom promenon u vezi predložaka za izveštavanje.
3. Posebni obrasci za izveštavanje mogu se primenjivati za različite izveštajne subjekte. FOJ-K staviće na raspolaganju sve ove obrasce na veb stranici FOJ-K i obezbediće smernice o primeni ovih formulara.

Član 8 Stupanje na snagu

Ovo Administrativna Direktiva stupa na snagu 15 dana nakon potpisivanja od strane Direktora Finansijske Obaveštajne Jedinice Kosova.

Priština, 12/01/2015


Dardan NUHIU
Direktor, Finansijske Obaveštajne Jedinice Kosova

procedures, reporting to the FIU suspicious acts or transactions and in training its employees.

Article 7 Reporting forms

1. All reporting subjects must submit the SAR and cash transaction reports CTR in accordance with the legislation in force and specifications defined by FIU-K.
2. FIU-K will continue to inform reporting subjects regarding any change concerning the reporting templates.
3. Specific reporting forms may be applicable to different reporting subjects. The FIU-K shall make available all these forms on the FIU-K website and provide guidance on application of these forms.

Article 8 Entry into force

This Administrative Directive enters into force 15 days after the signature by the Director of Financial Intelligence Unit of Kosovo.

Pristina, 12/01/2015


Dardan NUHIU
Director, Financial Intelligence Unit of Kosovo

ANEKSI 1 – LISTA E INDIKATORËVE PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE

I. INDIKATORËT E PËRGJITHSHËM

1. Indikatorët e pastrimit potencial të parave të shënuar më poshtë synojnë ngritjen dhe vetëdijesimin e subjekteve raportuese në pajtim me LPP/PFT. Këta indikatorë në vijim nuk nënkuptohet se janë të vetmit por vetëm ofrojnë shembuj për mënyrat më bazike se si mund të bëhet pastrimi i parave:

- 1.1. Llogari biznesi përmes të cilave bëhet numër i madh i transfereve hyrëse dhe dalëse elektronike dhe për të cilat duket se nuk ka ndonjë biznes logjik apo qëllim ekonomik, veçanërisht kur ky aktivitet është në, përmes apo nga vendet të cilat ngritin shqetësimin të veçantë;
- 1.2. Llogaria e fjetur që përmban shumë minimale e papritmas pranon një depozitë apo një seri depozitash, që pasohet nga tërheqjet ditore të parave në të gatshme të cilat vazhdojnë derisa të largohet e tërë shuma e depozituar;
- 1.3. Aktiviteti i llogarisë është jo-konsistent me profilin e klientit;
- 1.4. Llogaritë që pranojnë depozitime relevante periodike e të cilat pasivizohen gjatë periudhave tjera;
- 1.5. Llogaria nga e cila disa persona kanë autoritet nënshkrimi, por këta persona duket se nuk kanë relacione me njëri-tjetrin;
- 1.6. Llogaria e hapur nga një person juridik e cila ka adresë të njëjtë si personat tjerë juridik apo organizatat por për të cilat i njëjti person apo persona kanë autoritet nënshkrimi, kur nuk ekziston ndonjë arsye e dukshme ekonomike apo ligjore për një aranzhim të tillë;
- 1.7. Llogaria e hapur në emrin e një personi juridik të sapo-formuar dhe në të cilin bëhen depozitime më të larta se ato të pritura në krahasim me të hyrat e themeluesve të personit juridik;
- 1.8. Llogaria e përfituesit nuk është identifikuar si duhet;
- 1.9. Tërheqjet në para në të gatshme kryhen në degë të ndryshme bankare dhe/ose ATM, në të njëjtën ditë;
- 1.10. Klienti i ofron shpërblime përfaqësuesve të institucionit financiar për ti ndihmuar të anashkaloj procedurat KPP/LFT;
- 1.11. Klienti pranon transfere të shumëfishta vendore në vlera të larta në llogarinë e tij personale nga llogaria e një kompanie, që pasohet nga transferi dalës ndërkombëtar të fondeve ekuivalente në vlerë me transferet vendore;
- 1.12. Klienti paraqet kërkesë për të dërguar fondet nga llogaria e pensionit në llogarinë e re të posa-hapur dhe më pastaj, pas një kohe të shkurtë, kryen transfer ndërkombëtar të fondeve;
- 1.13. Depozitat për biznesin në kombinime të instrumenteve monetare të cilat nuk janë tipike për aktivitetin i cili normalisht zhvillohet në biznesin e tillë;
- 1.14. Shkëmbimi i transaksioneve ndërkombëtare të realizuara në emër të klientit nga palë e tretë, e pasuar nga transferet elektronike të fondeve në vendet që nuk kanë lidhshmëri biznesore me klientin apo shtetet e caktuara në fjalë;
- 1.15. Depozitimet në para në të gatshme në vlera të larta për të paguar transferet ndërkombëtare të fondeve;
- 1.16. Qarkullim i lartë në llogarinë që përfshin shuma të konsiderueshme të fondeve në para në të gatshme;
- 1.17. Transfere ndërkombëtare të fondeve nga llogaria individuale të disa llogari “offshore” të mbajtura nën të njëjtin emër;

- 1.18. Transferet ndërkombëtare të fondeve të dërguara në juridiksionet që paraqesin rrezik të lartë;
- 1.19. Përfshirja në transaksione e individëve të cilët janë pjesë e listës së njohur ndërkombëtarisht të individëve dhe organizatave, siç përcaktohet me Urdhëresë Administrative;
- 1.20. Depozitime të mëdha në para në të gatshme të bëra në llogarinë individuale apo të personit juridik ku normalisht aktiviteti i biznesit të individit apo personit juridik mund të bëhet në metoda tjera të pagesës;
- 1.21. Vlera të larta të depozitimeve të çeqeve në llogaritë e reja të posa-hapura bankare që pasohen nga tërheqjet e menjëhershme të parave në të gatshme menjëherë;
- 1.22. Përzierja e depozitave të parave në të gatshme dhe instrumenteve monetare në një llogari në të cilën transaksionet e tilla nuk duken se kanë ndonjë lidhje me përdorimin normal të llogarisë;
- 1.23. Klientët e shumëfishtë bëjnë transfere ndërkombëtare të fondeve të përfituesit e njëjtë në vendet “offshore”;
- 1.24. Transferet e shumëfishta të fondeve të cilat duket se kanë lidhje dhe bëhen nga i njëjti lokacion;
- 1.25. Transferet e shumëfishta të fondeve të cilat duket se kanë lidhje me shtetet të cilat paraqesin rrezik të lartë droge;
- 1.26. Transferet e shumëfishta të fondeve të cilat duket se kanë lidhje me përfituesit e përbashkët;
- 1.27. Lokacionet e shumëfishta gjeografike të cilat shfrytëzohen për të kryer transferet që duket se janë të ndërlidhura;
- 1.28. Transferet e shumëfishta të fondeve në vlera të ulëta të cilat duket se janë të ndërlidhura;
- 1.29. Transferet e shumëfishta të fondeve ndërkombëtare në vlera të ulëta të cilat duket se janë të ndërlidhura, dhe mundësisht tregojnë shuma të madhe të fondeve të ndara në shuma të vogla (shpërndarje).
- 1.30. Transaksionet e shumëfishta të cilat duket të jenë të lidhura, të kryera në të njëjtin ditë në të njëjtën degë të institucionit financiar por me tentim të dukshëm për të përdorë sportelista të ndryshëm;
- 1.31. Transaksionet e shumëfishta të cilat duket të jenë të lidhura, që ndodhin në të njëjtën ditë nga lokacione të ndryshme gjeografike;
- 1.32. Transaksionet e shumëfishta të cilat duket të jenë të lidhura, që ndodhin në të njëjtën ditë tek i njëjtit përfitues;
- 1.33. Transaksionet e shumëfishta të cilat duket të jenë të lidhura, që ndodhin në të njëjtën ditë me depozitime të shumta dhe të mëdhapërmes ATM-ve;
- 1.34. Kërkesat e shpeshta për kredi që duket se janë të ndërlidhura;
- 1.35. Transferet dalëse korrespondojnë të jenë transfere hyrëse të fondeve që duken të jetë transaksion ‘kthyes’;
- 1.36. Blerja e aseteve në vlerë të lartë (p.sh. patundshmëri, vetura luksoze);
- 1.37. Depozitime të rregullta të shumëfishta në para në të gatshme të cilat duket se janë të ndërlidhura dhe nën pragun raportues prej 10,000 Euro të transaksionit të parave në të gatshme;
- 1.38. Blerja e rregullt apo e shumëfishtë dhe inkasimi në para në të gatshme të çipave të lojërave të cilat duket se janë të ndërlidhura dhe nën pragun raportues prej 10,000 Euro të transaksionit të parave në të gatshme;
- 1.39. Kërkesat e përsëritura përverifikim të shpejtë të çeqeve nga klienti;
- 1.40. Adresa e njëjtë e shtëpisë e ofruar për transferet e fondeve nga njerëz të ndryshëm;
- 1.41. Metodatat e njëjta apo të ngjashme të përdorura për të marrë më shumë se një kredi bankare;
- 1.42. Transaksionet brenda një dite në lokacionet e ndryshme gjeografike;

- 1.43. Adresa e përbashkët për individët e përfshirë në transaksionet në para në të gatshme, veçanërisht kur adresa është gjithashtu edhe lokacioni biznesi dhe/ose nuk duket se korrespondon me profesionin e deklaruar (për shembull student, i papunë, i vetë-punësuar, etj);
- 1.44. Tërheqje të theksueshme të parave në të gatshme nga llogaritë e kontributit pensional;
- 1.45. Transaksione të ngjashme të kryera përgjatë një periudhe të shkurtë kohore;
- 1.46. Profesionin e deklaruar i transaferuesit nuk korrespondon me nivelin apo llojin e aktivitetit, për shembull, studenti apo individi i papunë i cili pranon apo dërgon numër të mëdha të transfereve elektronike, apo i cili bën tërheqje të shumfishta maksimale ditore të parave në të gatshme në lokacione përgjatë një rrethi të gjerë gjeografik;
- 1.47. Strukturimi i fondeve përmes transfereve apo transaksioneve;
- 1.48. Strukturimi i blerjeve të basteve, pagesave dhe tërheqjeve;
- 1.49. Klienti refuzon të ofroj informata të kërkuara nga institucioni financiar gjatë hapjes së llogarisë, tenton që të zvogëlojë nivelin e informatave të ofruara në minimum apo ofron informata ç'orientuese apo që vështirë verifikohen;
- 1.50. Depozitimi apo tërheqja e parave në të gatshme në shuma të cilat në mënyrë të vazhdueshme janë shumë afër nën-pragun identifikues apo raportues;
- 1.51. Depozitimi apo tërheqja e instrumenteve të shumfishta monetare në shumat të cilat në të vazhdueshme janë shumë afër nën-pragun identifikues apo raportues;
- 1.52. Hapja, nga i njëjti person, i llogarive të shumfishta në të cilat bëhen depozitime të shpeshta të vogla që kur të bashkohet nuk janë në përpjesëtim me të ardhurat e pritura të klientit;
- 1.53. Strukturimi i depozitave përmes degëve të shumfishta të të njëjtit institucion financiar apo nga një grup i individëve të cilët hyjnë në të njëjtën degë njëkohësisht;
- 1.54. Transaksioni nuk ka ndonjë qëllim racional (të qartë dhe relevant) ekonomik apo biznesor;
- 1.55. Transaksioni nuk është ekonomikisht i arsyeshëm, duke pasur parasysh biznesin dhe profesionin e bartësit të llogarisë;
- 1.56. Përdorimi i llogarive të huaja të anëtarëve të familjes, të emëruarve etj;
- 1.57. Mos-përputhjet e pashpjegueshme që rrjedhin nga procesi i identifikimit apo verifikimit të klientit (për shembull, përkitazi me shtetin e mëparshëm apo të tanishëm të banimit, shtetit që ka lëshuar pasaportën, shtetet e vizituara sipas pasaportës, dokumentet e ofruara për të konfirmuar emrin, adresën dhe data e lindjes);
- 1.58. Aktiviteti i pazakonshëm i parave në të gatshme në llogaritë në bankë të huaj, depozitimet të shumfishta në shuma të vogla dhe transferimet e tyre në shuma të mëdha në shtetet e huaja.
- 1.59. Përdorimi i bizneseve fiktive, përfshirë kompanitë “offshore”;
- 1.60. Përdorimi i dokumenteve false;
- 1.61. Transferet elektronike të urdhëruara në shuma të vogla në përpjekje për t'iu shmangur kërkesave të identifikimit apo raportimit;
- 1.62. Transferet elektronike tek apo për individin, kur informatat mbi dërguesin, apo personin në emër të të cilit bëhet transaksioni, nuk janë dhënë me transferin elektronik, atëherë kur përfshirja/dhënia e informatave të tilla është e pritshme;

II. INDIKATORËT SPECIFIK

2.1. Indikatorët specifik lidhur me transaksionet që kanë të bëjnë me “parajsat” tatimore, qendrat (offshore) apo shtetet dhe juridiksionet jo-bashkëpunuese

- 2.1.1. Kompanitë apo institucionet financiare të përfshira janë themeluar në vendet të njohura si “parajsat” tatimore apo qendrat “offshore”;
- 2.1.2. Pagesat përmes llogarive përdoren në mënyrë të vazhdueshme për fondet me origjinë nga jashtë. Këto fonde më pastaj janë transferohen shpejt në llogaritë e kompanive në vendet e njohura si “parajsat” tatimore apo qendrat offshore;
- 2.1.3. Transaksionet dhe kompanitë e përfshira janë nga shtetet apo juridiksionet jo-bashkëpunuese të përcaktuara nga TFVF.

2.2. Indikatorët specifik përkitazi me kreditë

- 2.2.1. Investime të mëdha në patundshmëri duke përdorë kredive të pasuara nga shlyerja e shpejtë dhe e hershme e parave të tërhequra;
- 2.2.2. Shlyerja e pengut të kredisë përmes transfereve apo depozitimeve në para në të gatshme, jo-proporcionale me të ardhurat zyrtare të palëve të përfshira.

2.3. Indikatorët specifik përkitazi me kompanitë e sigurimit

- 2.3.1. Klienti anulon produktin e pensionit vjetor brenda periudhës provuese (“free look”);
- 2.3.2. Klienti anulon kontratën e sigurimit dhe urdhëron që fondet ti dërgohen palës së tretë;
- 2.3.3. Klienti anulon kontratën pa shqetësime për tatimin e konsiderueshëm apo për ngarkesat tjera të anulimit që, si rezultat i anulimit, ai apo ajo duhet ti paguaj;
- 2.3.4. Klienti depoziton çekun e sigurimit pensional nga polisa e anuluar dhe menjëherë kërkon tërheqjen apo transferimin e fondeve;
- 2.3.5. Klienti hyn në kontratë për një shumë të konsiderueshme që i nënshtrohet pagesës së premiumeve nga jashtë, veçanërisht nga ndonjë qendër financiare “offshore”;
- 2.3.6. Klienti është veçanërisht i interesuar në dorëzimin e hershëm të produktit dhe në shumën të cilën ai mëpastaj do ta ketë në dispozicion të tij;
- 2.3.7. Klienti hap dhe mbyll llogari në kompaninë e sigurimit, vetëm për të hapur menjëherë pas kësaj llogari të re me të njëjtën kompani sigurimesh, por me informata të reja mbi pronësinë apo pronari;
- 2.3.8. Klienti blen polisë të vetme premium duke përdorë para në të gatshme, urdhëresa parash, çeqe udhëtarësh apo çeqe arkash për një shumë e cila qartë nuk është në proporcion me të ardhurat e klientit;
- 2.3.9. Klienti blen kontratë sigurimi duke përdorë pagesë të vetme premium në vlerë të madhe, veçanërisht me metodë të pazakonshme pagese, siç janë paratë në të gatshme apo metoda ekuivalente me paranë të gatshme;
- 2.3.10. Klienti blen produktin e sigurimit pa shqetësim për objektivin apo performancën e investimit;
- 2.3.11. Klienti blen produktin e sigurimit me burim të panjohur apo të pa verifikueshëm të fondeve, siç mund të jetë me paratë në të gatshme, urdhëresa të shumta të vazhdueshme të parave, çeqet e udhëtarëve, dhe/ose çeqet e arkave;
- 2.3.12. Klienti siguron kredinë e polisës kundrejt vlerës së parave në të gatshme dhe menjëherë pasi që i lëshohet polisa, shlyen kredinë me para në të gatshme apo instrumente të ndryshme monetare.

- 2.3.13. Klienti zëvendëson, gjatë periudhës së kontratës, pronarin përfitues fillestar me një person që nuk ka ndonjë lidhje të dukshme me mbajtësin e polisës.

2.4. Indikatorët specifik përkitazi me noterët

- 2.4.1. Sendet e paluajtshme shiten në mënyrë të përsëritur me fitim të pajustificueshëm dhe për këto transaksione nuk mund të ofrohet shpjegim i qartë;
- 2.4.2. Pagesat janë bërë në emër të klientit në llogari të noterit që burojnë nga institucionet financiare, kompanitë e themeluara në, apo individët që banojnë në, shtetet që njihen për lejimin e fshehtësisë bankare, sistemin e favorshëm fiskal, prodhimin e drogave, apo si shtet dhe juridiksion jo-bashkëpunues në listën e TFVF;
- 2.4.3. Klienti nuk jeton në regjionin ku noterit ka zyret apo nuk bën pjesë në klientelën e zakonshme të noterit, përdor si ndërmjetës personin e panjohur për noterin apo kërkon nga noterit shërbim të cilin klienti në lëmin e tij mund ta bëjë edhe vetë, dhe as klienti e as noterit tjetër nuk kanë ndonjë shpjegim adekuat;
- 2.4.4. Klienti ka krijuar apo dëshiron të krijoj kompani të ndryshme brenda një periudhe të shkurtë për veti apo në dobi të personit tjetër përderisa nuk ka apo nuk duket të ketë ndonjë arsye legjitime fiskale, ligjore apo komerciale për të bërë këtë;
- 2.4.5. Klienti është i përfshirë në aktivitete të pazakonshme dhe aktiviteti nuk duket të jetë në lidhshmëri apo është jashtë çdo përmase me ushtrimin normal të profesionit apo aktiviteteve të tij dhe ai nuk mund ti ofroj noterit shpjegime adekuate;
- 2.4.6. Klienti refuzon apo kundërshton ti ofroj noterit numrin e llogarisë përmes të cilit shuma ishte apo do të debitohet;
- 2.4.7. Klienti refuzon të paguaj apo kundërshton të paguaj çmimin e shitjes përmes transferit bankar apo çekut, edhe pas shuma tejkalon pragun prej 10,000 EUR;
- 2.4.8. Klienti në mënyrë të përsëritur ndryshon noterët brenda një periudhe të shkurtë kohore e noterit nuk gjen ndonjë shpjegim adekuat për sjelljen e tij;
- 2.4.9. Klienti përdor një person “kukull” pa ndonjë arsye legjitime fiskale, ligjore apo komerciale për të bërë këtë;
- 2.4.10. Klienti përdor dokumentet, veçanërisht dokumente identifikimi të cilat duket se mund të jenë të falsifikuar;
- 2.4.11. Klienti përdor apo dëshiron të përdorë kompanitë e huaja, edhe pse nuk ka apo duket se nuk ka ndonjë arsye legjitime fiskale, ligjore apo komerciale për të bërë këtë;
- 2.4.12. Klienti përdor apo dëshiron të përdorë kompani të dyshimta, edhe pse nuk ka apo duket se nuk ka ndonjë arsye legjitime fiskale, ligjore apo komerciale për të bërë këtë;
- 2.4.13. Klienti dëshiron të themeloj apo të blejë kompani me objektiv të dyshimtë apo kompani e cila duket se nuk ka ndonjë lidhje me aktivitetet e tij normale profesionale apo ndihmëse dhe ai nuk mund ti ofroj noterit shpjegime adekuate;
- 2.4.14. Klienti dëshiron të paguaj paraprakisht (avanc) në para në të gatshme shumë që tejkalon pragun prej 10 000 EUR;
- 2.4.15. Noteri pranon para nga klienti për të paguar palën e tretë, ndonëse noterit nuk mund të gjej ndonjë shpjegim për të arsyetuar këtë pagesë.

2.5. Indikatorët specifik përkitazi me avokatët

- 2.5.1. Klientët kërkojnë nga avokatët që ti njoftojnë ata me institucionet financiare;
- 2.5.2. Shitja apo blerja e paluajtshmërive për çmim tepër të lartë apo tepër të ulët në krahasim me vlerën e saj;

- 2.5.3. Investimet në paluajtshmëri nga shtetasit e huaj pa ndonjë lidhje me Kosovën apo jashtë të gjitha përmasave të statusit socio-ekonomik të klientit;
- 2.5.4. Llogaritë e palës-së-tretë të avokatëve përdoren nga njerëzit të cilët dëshirojnë të mbeten anonim;
- 2.5.5. Klientët u qasen avokatëve kur themelojnë kompanitë siç janë trustet dhe kompanitë ndërkombëtare biznesore apo me qëllim të ruajtjes së anonimitetit të tyre dhe maskimit të origjinës ilegale të fondeve.

2.6. Indikatorët specifik përkitazi me kazinot

- 2.6.1. Klienti bën blerje në shuma jo-proporcionale me statusin e tij të njohur financiar;
- 2.6.2. Klienti, sjellja e të cilit gjatë lojës nuk korrespondon me atë të bixhozxiut normal dhe kur synimi për të fituar dukshëm mungon apo është sekondar.
- 2.6.3. Palët e treta përfshihen në depozitim dhe tërheqjen e fondeve në kazino.

2.7. Indikatorët specifik përkitazi me agjentët e paluajtshëmive

- 2.7.1. Klienti blen paluajtshmëri në emër të palës së tretë pa ndonjë lidhje të dukshme me klientin;
- 2.7.2. Klienti blen paluajtshmëri pa e parë fare pronën;
- 2.7.3. Klienti refuzon apo kundërshton ti ofroj noterit numrin e llogarisë përmes të cilës shuma do të debitohet;
- 2.7.4. Klienti refuzon të paguaj apo kundërshton të paguaj çmimin e shitjes përmes transferit bankar apo çekut ndonëse shuma tejkalon pragun prej 10 000 EUR;
- 2.7.5. Klienti përdor emra të ndryshëm për marrëveshjen e shitjes, shitjen dhe pagesën;
- 2.7.6. Klienti dëshiron të blej paluajtshmëri me një shumë të konsiderueshme në para në të gatshme;
- 2.7.7. Klienti dëshiron të paguaj paraprakisht (avanc) në para të gatshme në shumën që tejkalon pragun 10, 000 EUR.

2.8. Indikatorët specifik përkitazi me kontabilistët certifikuar, auditorët e licencuar, këshilltarët tatimor, këshilltarët e jashtëm tatimor, dhe kompanitë e auditimit (profesionistët në fjalë)

- 2.8.1. Emërimi i aksionerëve është në mos-përputhje me aktivitetin e biznesit;
- 2.8.2. Kontrollimi i librave zbulon përvetësim ilegal;
- 2.8.3. Klienti në mënyrë të përsëritur i drejtohet profesionistëve të ndryshëm të kontabilitetit;
- 2.8.4. Mënyra e jetesës së klientit është përtej të ardhurave të tij/saj, duke pasur parasysh aktivitetet e tij/saj profesionale;
- 2.8.5. Kompania nuk ka asnjë punëtor, që është jo-normale duke pasur parasysh aktivitetin e biznesit;
- 2.8.6. Kompania paguan honorare të ndryshme konsulence për kompanitë “offshore”;
- 2.8.7. Kompania blen barka dhe vetura luksoze pa ndonjë lidhshmëri me aktivitetin biznesor;
- 2.8.8. Të ardhurat që buronin nga aktivitetet profesionale të klientit janë jo-proporcionale me aktivitetin biznesor.

PRILOG 1- LISTA INDIKATORA ZA SPREČAVANJE PRANJA NOVCA

I. OPŠTI INDIKATORI

1. Pokazatelji potencijalnog pranja novca definisani u nastavku su prvenstveno namenjeni za podizanje svesti među izveštajnim subjektima u skladu sa ZSPNFT. Sledeća lista nije namenjena da bude iscrpna i pruža primere pokazatelja sa kojima može se identifikovati pranje novca:

- 1.1. Poslovniračunprekokojegvelikibrojdolazniiliodlaznielektronskitransferiseodvijajuizakojeizgledadanepostojilogičnaposlovnailidrugogekonomske svrha, posebno kada ova aktivnost je za, preko ili iz lokacije od posebne zabrinutosti;
- 1.2. Uspavan (neaktivan) račun koji sadrži minimalnu sumu od jednog primadepozitilinizdepozitanakon čega sledi dnevno podizanje gotovog novca i nastavlja se dok prenetasumaje uklonjena;
- 1.3. Aktivnost računa nedosledna sa profilom klijenata;
- 1.4. Računi koji primaju relevantne periodične depozite a uspavani u drugim periodima;
- 1.5. Račun za koji više lica imaju pravo potpisa, ali izgleda da ova lica nemaju međusobne veze;
- 1.6. Račun otvoren od strane pravnog lica koji ima istu adresu kao druga pravna lica ili organizacije, ali za kojeg isto lice ili lica imaju pravo potpisa, kad ne postoji očigledno ekonomski ili pravni razlog za takav sporazum;
- 1.7. Račun otvoren na ime nedavno formiranog pravnog lica i u kojem većinego očekivani nivo depozita su napravljeni u odnosu na prihode od osnivača subjekta;
- 1.8. Korisničkiračun nije pravilno identifikovan;
- 1.9. Podizanje gotovine sprovedene u raznim bankarskim granama i/ili bankomatima (ATM) istog dana;
- 1.10. Korisnik koji nudi podsticaje predstavnicima finansijske institucije da mu pomognu u zaobilaženjeAML/CTF postupaka;
